



Kolegji AAB
CILËSI. LIDERSHIP. SUKSESI!

Programi: Komunikim masiv dhe gazetari

Studimet Master

Punim masteri

**PËRDORIMI I INTERNETIT NGA ADOLESHENTËT, NË
SHKOLLAT E MESME TË KOMUNAVE GJILAN,
KAMENICË, VITI DHE FERIZAJ**

Kandidatja: Hasije Korça

Mentori: Prof. Ass. Dr. Jeton Kelmendi

Prishtinë, 2021

PERMBAJTJA

LISTA E FIGURAVE.....	
LISTA E TABELAVE.....	
LISTA E GRAFIKËVE	
LISTA E SHKURTESAVE.....	
DEKLARATA E ORIGJINALITETIT	
DEKLARATA E LEKTORIT	
MIRËNJOHJE	
Abstrakti.....	
Abstract.....	
KAPITULLI I	
1. HYRJA	
1.1. Parashtrimi i problematikës	
1.2. Struktura e punimit	
1.3. Objektivi i studimit	
1.4. Qëllimi i Studimit	
1.5. Metoda e hulumtimit/ Hipotezat	
1.6. Pyetjet qe shtrohen/hipotezat	
1.7. Hipotezat.....	
1.8. Rëndësia e temës.....	
2.0 Rëndësia e përdorimit të internetit nga adoleshentët	
2.1. Përdorimi i internetit domosdoshmëri te të rinjtë – adoleshentë	
2.2 Përfitimet nga përdorimi i shërbimeve në internet	
2.2.1 Përdorimi i internetit për nevoja në arsim.....	
2.2.2 Ndikimi i internetit në rregullimin e marrëdhënieve shoqërore në mes adoleshentëve	
2.3. Ndikimi i internetit në zhvillimin psiko-social te adoleshentët	
2.3.1. Kujdesi prindëror te adoleshentët përdorues të internetit.....	
2.4. Rreziqet potenciale që sjell përdorimi i internetit nga adoleshentët	
2.4.1. Varësia nga internet	
2.4.2. Depresioni dhe trishtimi.....	

2.4.3. Ankthi	
2.4.4 Izolimi social.....	
2.4.5. Luhatjet e humorit.....	
3.0 Rezultatet e hulumtimit nga pyetësi	
3.1 Përshkrimi i rezultateve	
4.0 PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMET	
Analiza e gjetjeve të studimit.....	
Rekomandime dhe këshilla	
Aneks pyetësi.....	
REFERENCAT.....	

DEKLARATA E ORIGJINALITETIT

Duke u bazuar në Rregulloren për organizimin e studimeve master dhe në kodin e mirësjelljes, me përgjegjësi të plotë morale e ligjore deklaroj se materiali i prezantuar në punimin tim të diplomës MSc është krejtësisht punë e imja dhe se në të nuk ka veprime që do të mund të klasifikoheshin si plagjiaturë.

Deklaroj se në mënyrë korrekte dhe me saktësi u jam referuar të gjitha burimeve të literaturës së përdorur në punim.


Me përgjegjësi të plotë ligjore deklaroj se jam i vetëdijshëm për pasojat e një deklarimi të rrejshëm.

Hasije Korça

22. 06. 2021

DEKLARATA E LEKTORIT

Me anë të kësaj deklarate, unë Fehri Qerimi, deklaroj se lekturimi është rezultat i punës sime origjinale dhe është bërë personalisht nga vetë unë. Asnjë pjesë e këtij punimi nuk është lekturuar nga askush dhe pranoj përgjegjësitë e mia të cilat do të më ngarkohen nga cilido komision apo organ që eventualisht do të shqyrtojë ndonjë rast ankese apo mosmarrëveshjeje lidhur me lekturimin e punimit, dhe në të njëjtën kohë pranoj të gjykohej, por, në bazë të fakteve.



Fehri Qerimi

Datë: 21 qershor 2021

MIRËNJOHJE

Gjatë rrugëtimit tim në finalizimin e studimeve master i jam mirënjohëse shumë njerëzve të cilët më kanë ndihmuar dhe mbështetur vazhdimisht. Së pari, shpreh falënderimet e mia të sinqerta për udhëheqësin tim, profesorin e nderuar, Prof. Dr. Jeton Kelmendi për ndihmën e pakushtëzuar profesionale dhe pozitivitetin që gjithmonë ka transmetuar te unë. Një falënderim i veçantë shkon për të gjithë pedagogët e mi ndër vite të cilët me profesionalizmin dhe modelin e ofruar kontribuan në rritjen dhe zhvillimin tim akademik dhe profesional. Mirënjohje dhe falënderime pa fund për Prof.. Dr. Hasan Saliu për këshillat që më kanë dhënë në përpilimin e temës së masterit. Falënderime edhe për profesorin e nderuar, Resul Sinani për mbështetjen e ofruar. Një tjetër falënderim shkon për të gjithë adoleshentët, pa të cilët realizimi i këtij studimi do të ishte i pamundur. Falënderoj shoqen time Ardita Sallahaj, për përkrahjen, mbështetjen, ndihmën dhe çastet e paharruara që kemi kaluar gjatë finalizimit të studimeve master e që ka qenë pranë meje, për të më dëgjuar dhe inkurajuar. Falënderoj bashkëshortin tim për mbështetjen, përkrahjen dhe kurajën e vazhdueshme që gjithmonë kanë ditur të transmetojnë te unë, gjithashtu për të mrekullueshmit fëmijët e mi të cilët edhe që e ka ndjerë nevojën për prezencën time më kanë mirëkuptuar edhe që është dashur të merrem me punët e mia.. Një falënderim i veçantë shkon për vëllain tim Dr. Ejup Imeri, pavarësisht se larg në distancë, ai ka qenë pranë meje në çdo moment të jetës sime, i jam shumë mirënjohëse për ndihmën e pakushtëzuar që vetëm ai di ta japë. Dhe në fund, në pamundësi për ti përmendur të gjithë, falënderoj të gjithë njerëzit që zënë një vend të veçantë në zemrën time dhe që kam pasur fatin t'i kem pjesë të jetës sime. Faleminderit!!!

Abstrakti

Nga studime të shumta është vërejtur se objekt i studimit ka qenë përdorimi i internetit nga adoleshentët, mirëpo qasja për këtë fenomen ndryshon varësisht nga variablat që merren për studim. Objektivi kryesor i këtij hulumtimi është dallimi ndërmjet Përdorimit Problematik të Internetit (GPIU) dhe Përdorimit Specifik të Problemeve të Internetit (SPIU), raporti ndërmjet sasisë dhe cilësisë së përdorimit të internetit. Rëndësia e këtij studimi është se synon të hedhë dritë mbi “përdorimin e internetit nga adoleshentët” dhe ndikimin e drejtpërdrejtë të saj në jetën e tyre. Metoda e hulumtimit është : metoda cilësore dhe sasiore. Mënyra e hulumtimit dhe instrumentet që janë përdorur kanë dhënë rezultate në vërtetimin e hipotezave, kryesisht hipotezës së përgjithshme si: *Përdorimi i internetit kërkesë imediate e kohës*. Të dhënat nga pyetësi kryesisht janë analizuar në nivel deskriptiv. Sipas gjetjeve të hulumtimit përdorues janë më shumë vajza se djem. Rezultatet kanë dhënë përgjigje se përdorimi i internetit është domosdoshmëri. Përdorimi për kohë të gjatë përveç që krijon varshmëri është edhe pjesë e përditshmërisë që plotëson nevoja: ndihmon në socializim, ndihmon në procesin arsimor etj.. Ky hulumtim sjellë risi në këtë fushë duke ndihmuar prindërit, shkollat, psikologët e shkollave, hartuesit e planprogrameve, dhe studiuesit.

Fjalët kyçe: interneti, adoleshentët, përparësitë, rreziqet, socializimi, izolimi social

Abstract

Numerous studies have shown that the object of studying has been the use of the Internet from adolescents, but the approach for this phenomenon varies from the variables that are taken too be studied . The main objective of this research is the difference between the wrongful use of the internet (GPIU) and the specific use of the internet problems (SPIU) , the relationship between the amount and the quality of the use of the internet . The importance of this study is that it aims to shed light on : “The use of interenet from adolescents” and the direct impact in their life . The methods of research used are : The quality method and the quantitative method . The method of research and the tools used have shown that the hypothesis is true , mostly the hypothesis : *The use of internet is a requirement of the time*. The data from the questionnaire have been analysed in a descriptive level .According to the results of this research the users are mostly girls rather than boys .The results have shown that the use of Internet is a must. The excessive use not only causes addiction it is also a part of a daily activity that meets needs : helps socialising , helps in the educational procces ,etc.. This research brings a new angle on this field by helping parents , schools, psychologists in schools , curriculum complies and researchers.

Key Words : Internet , adolescents , advantages , risks , socialism , social isolation

HYRJA

Parashtrimi i problematikës

Viteve të fundit në Kosovë, interneti ka fituar një popullaritet të theksuar sikurse në gjithë botën. Interneti është mbase mediumi më interaktiv sot. Faqet e internetit janë kthyer në një forum mbizotërues botëror për fëmijët, adoleshentët dhe të rriturit. Kjo është bërë e mundur, pasi gjatë dekadave të fundit edhe zhvillimet e teknologjisë kanë pasur një ndikim të madh në jetën e njerëzve në të gjithë botën. Gjetjet nga Pew Internet dhe American Life Project tregojnë se 87% e të gjithë të rinjve midis 12 dhe 17 vjet përdorin kompjuter, në veçanti internetin¹. Këto mjete të komunikimit nëpërmjet internetit janë bërë pjesë e rëndësishme e jetës. Mediat sociale janë zhvilluar me hapa marramendës, janë shumëfishuar, duke u shndërruar në hapësira shumë të vizituara. Hulumtime të shumta kanë gjetur se faqe të tilla-mediat sociale sot kanë miliarda përdorues, shumë prej tyre adoleshentë dhe të rritur në zhvillim. Ende sot vazhdojnë të bëhen kërkime mbi përdorimin e internetit nga të rinjtë.

Interneti nga fillimet e veta pati një ndikim, mbi të gjitha në komunikim dhe rrjedhimisht edhe në të gjitha proceset e jetës. U lidh ngushtë me rrjetet sociale e edhe me transferimin e koncepteve kulturore nga të gjitha pjesët e botës duke përmbushur një mision mediatik. Ndër të tjera, interneti është bërë mjet strategjik në kontekstin e politikave globale duke qar në një revolucion të madh dimensionet e hapësirave virtuale. Ky revolucion është bërë i dukshëm me ardhjen e celularëve, i ndjekur nga zhvillimi i internetit, veçanërisht te adoleshentët. Nevojat reale dhe praktike të kësaj gjenerate, kanë nxjerrë në pah nevojën e studimit të aspekteve të ndryshme, të faktorëve ndikues dhe mbresëlënës të teknologjisë së komunikimit. Përdorimi në masë të madhe i internetit dhe mediave sociale në botë, tregon rëndësinë e përdorimit dhe statusin e veçantë të tyre. Në një raport të Bankës Botërore deri në vitin 2015, gjysma e popullsisë botërore (44%) kanë qasje në internet.² Interneti tashmë është bërë një nga mjetet më të fuqishme të komunikimit në botë.

¹ Lenhart, A., Madden, M., & Hitlin, P. (2005). *Teens and technology*, Washington, DC: Pew Internet and American Life Project

² TheWorld Bank (2020). *Annual Report 2019 Organizational Information*. Marrë nga webfaqja. <http://pubdocs.worldbank.org> > worldbankannual

Sipas të dhënave Kosova është përfshirë me vonesë në krahasim me botën dhe vendet e rajonit. Mirëpo, prapë se prapë vlerësohet se ka hyrë fuqishëm nëse merret parasysh numri i përdoruesve të rrjeteve sociale dhe mediave sociale. Kështu Kosova është vendi me numrin më të madh të përdoruesve të internetit nga të gjitha vendet e rajonit. Në bazë të të dhënave të EUROSTAT-it, 81 përqind e popullsisë në Kosovë janë përdorues të internetit. Kjo është pasojë e zhvillimit të shpejtë të internetit. Ekspertët lokal të rrjeteve sociale thonë se numri i përdoruesve të rrjeteve sociale është shumë i madh. Sipas tyre 70% e popullatës marrin pjesë në këto media duke kaluar deri në 3h në ditë për shfrytëzimin e tyre. Portali i parë në Kosovë është hapur në vitin 2006 e megjithëkëtë të rinjtë e Kosovës kanë zënë trendet botërore.³

c. Ky kapital e kjo inteligjencë kolektive e grumbulluar kryesisht rreth rrjeteve sociale, nuk ka transformuar vetëm jetën e adoleshentëve, por edhe gjithë botën brenda saj. Janë të shumta studimet që ngrenë teza lidhur me ndikimin pozitiv të teknologjisë në komunikimin, sjelljen, arsimimin, në zhvillimet psikologjike dhe sociale, po ashtu edhe teza që mbështesin qëndrimet e tyre për ndikimin negativ në këto procese të jetës. Adoleshentët, ata që e përdorin atë më shumë sesa grupmoshat e tjera, e përdorin për arsye të ndryshme, nga qëndrimi që lidhet me bashkëmoshatarët dhe familjen e tyre deri te marrja e ndihmës akademike. Ky përdorim i tepërt i internetit po konsiderohet si dukuri negative dhe shpesh me rrezikshmëri të lartë. c. Kjo, për arsye se vetë kureshtja e adoleshentëve i bën ata të hulumtojnë më shumë në botën virtuale. Si pasojë e kësaj, shfaqen edhe efektet negative si: depresioni dhe trishtimi, ankthi, pagjumësia, izolimi social, gënjeshtria, luhatjet e humorit etj. Në një hulumtim të bërë nga [Hacettepe University Journal of Education] u gjet se nivelet e varësisë nga interneti te adoleshentët që kalojnë më shumë se 5 orë në ditë në internet janë më të larta se ato të adoleshentëve që kalojnë më pak se një orë në ditë në internet, mbështetet nga disa gjetje të hulumtimit.⁴

Kjo mundësi që u jep interneti adoleshentëve për të qëndruar 24^h të qashtëm mund të ketë edhe zhvillime pozitive për jetën e tyre krahas rreziqeve. Kjo varet shumë edhe nga vendi dhe

³ Kasapollli, A.S. (2016) *Të rinjtë, aktivë në mediat sociale*. Evropa e Lirë. Marrë nga webfaqja <https://www.evropaelire.org/a/28011457.html> > 2021/03

⁴ Eldeleklioglu, J. & Vural-Batik, M. (2013). *Predictive effects of academic achievement, internet use duration, loneliness and shyness on internet addiction*. Journal of Education, 28 (1), 141-152

pajisja me të cilën qasen në internet. Pra në moshën e adoleshencës interneti është bërë një mjet i rëndësishëm në jetën e tyre, burim i jashtëzakonshëm i informatave nga më të ndryshmet, ndihmon në ngritjen e potencialit për të mësuar dhe nxitë marrëdhëniet shoqërore. Ata tani fillojnë të bëhen më të pavarur, fillojnë të kenë më shumë vetëbesim, si dhe gjithnjë e më shumë duan liri. Ata në këtë moshë e kanë krijuar profilin e tyre në internet dhe janë të kyçur në rrjete sociale. Disa faqe në internet janë shumë të rëndësishme për jetën sociale të adoleshentëve. Në një studim, në mesin e adoleshentëve, mediat sociale janë të njohura si për djem ashtu edhe për vajza, por pabarazia është e qartë. Dyzet e katër përqind e vajzave adoleshente e shijojnë atë shumë, krahasuar me 29 % të djemve. (Përsëri, kjo është shumë më pak se përqindja e vajzave që thonë se kënaqen me muzikë “shumë” [80 %], ose djem që thonë se u pëlqejnë lojërave video "shumë" [62%]).⁵ Kjo na bënte kuptojmë se mediat sociale u imponohen të rinjve varësisht prej materialit që ofrojnë duke bërë edhe diferencime gjinore. Këtu lidhet ngushtë bashkëveprimi midis nevojës për identitetin personal të vetes dhe nevojës për lidhje të ngushta personale dhe përkatësive të forta të grupeve që përshkon të gjitha fushat e jetës së përditshme të adoleshentëve (Crosnoe & Johnson, 2011). Nga një studim i bërë në SHBA nga Amanda Lenhard dhe Mary Madden adoleshentët ndoshta më shumë se çdo grup-moshë tjetër në SHBA kanë qenë në gjendje më të favorshme për të përfutuar nga teknologjia e komunikimit gjegjësisht shfaqja e mediave sociale.

Duke pasur parasysh faktin se periudha e adoleshencës është një periudhë e trazuar e formimit të identitetit, mund të pohojmë se ata në këtë fazë të jetës janë të preokupuar intenzivisht me jetën shoqërore, dhe si pasojë aprovojnë të parët aplikacionet në internet që u ndihmojnë për të komunikuar me bashkëmoshatarët e vet. Sipas hulumtimit të (STIKK) moshë që më së shumti e përdorin internetin është nga 10-19 vjet, 22.86% ⁶

Nga fakti që jetojmë në kohën e zhvillimit të internetit dhe rrjeteve sociale ku përditshmëria jonë lidhet me informacionet që mund t’i gjejmë në faqet e internetit, atëherë fenomeni i përdorimit në masë të madhe të internetit nga të rinjtë-adoleshentët është një dukuri që na është bërë përditshmëri gati normale, gjithmonë duke u bazuar në interesat që sjell ky përdorim. Edhe fakti

⁵ Vicky Rideout, M.A., VJR Consulting Inc. (2015). *THECOMMON SENSE CENSUS: MEDIA USE BY TWEENS AND TEENS* 39, Delaney Family Fund. Marrë nga webfaqja https://www.common sense media.org/sites/default/files/uploads/research/census_researchreport.pdf >2021/03

⁶ Fazliu, A. (2013). *Depertimi dhe perdorimi i internetit ne Kosovë*. Kolegji Universitar Universum. Marrë nga webfaqja https://stikk.org/wcontent/uploads/2018/11/Publications_2013_-_Internet_Penetration_SQ.pdf > 2021/04

se adoleshentët janë mosha që më së shumti krijojnë varësi tregon se ka një arsyeshmëri që shfaqë këtë dukuri. Kapaciteti te adoleshentët i bën të hulumtojnë më shumë në botën virtuale. Mundësia e përdorimit të internetit pa limit bën që adoleshentët të shpenzojnë kohën më të madhe duke qenë të lidhur me komunitetin pa orar: në lojëra të ndryshme, faqe të internetit duke kërkuar informacione me interes për ta, rrjetet sociale etj. Kjo sipas hulumtimeve të shumta krijon varshmëri e që për pasojë ka efekte të dëmshme në shëndetin mendor duke shkaktuar ankth, depresion , trishtim, tërheqje në vetmi etj. Njerëzit që përdorin internet tepër mund të kenë më shumë gjasa të pësojnë depresion, zbulon studimi. Nga Bill Hendrick⁷. Ky çrregullim i varësisë nga interneti (IAD) zakonisht përcaktohet si një dëshirë e pakontrollueshme për ta përdorur internetin. Kjo është gjithsesi një temë që është diskutuar shpesh në shumë kontekste, shumë shpesh në drejtim të gjeneraliteteve të pashqyrtuara për të rinjtë që injorojnë kompleksitetin dhe gradualisht ndryshimin e natyrës së pjesëmarrjes së tyre në një kulturë të përbashkët dixhitale. Diskursi në lidhje me këtë çështje tenton të diskutojë edhe marrëdhënien midis të rinjve dhe teknologjive që ata përdorin, si përfituesit kryesor të epokës dixhitale. Tri pajisjet më kryesore që përdoren nga fëmijët për t'u kyçur në internet janë: kompjuterët personalë (PC-të) (70%), telefonat celularë (60%), dhe laptop-ët (50%).⁸

Duke u nisur nga këto të dhëna nga hulumtime të shumta lidhur me problematikën e marrë në shqyrtim në këtë hulumtim, atëherë këtu, ndër të tjera do të shqyrtohen specifikat në të cilat teknologjitë e reja kanë një kuptim të veçantë për adoleshentët si një grup i gjerë përdoruesish dhe specifikat që janë të ndryshme për të rinj të ndryshëm . Këto të dhëna do të nxirren nga një stratifikim social. Kjo, nga fakti se nocioni i adoleshentëve ka një rezon të veçantë në lidhje me teknologjitë dixhitale.

⁷ Desara, A., *Adoleshentët në Shqipëri*. UNIVERSITETI I TIRANËS. Për më shumë shih <http://www.doktoratura.unitir.edu.al> > 2021/05

⁸ Hendrick. B. (2010). *Internet Addiction Spins Web of Depression*. Webside, Për më shumë: <https://www.webmd.com/depression/news/20100204/internet-addiction-linked-to-depression> 2021/04

Struktura e punimit

Për të eksploruar çështje të tilla, është i nevojshëm referimi gjerësisht i shkrimeve të botuara, duke përfshirë edhe studime për adoleshencën, studime për të rinjtë dhe studime për përdorimin e teknologjisë në veçanti nga të rinjtë. Gjithashtu të kërkohen edhe informacione nga projekte të ndryshme kërkimore që kryesisht kanë të bëjnë me të rinjtë dhe raportin që kanë me përdorimin e internetit. Rezultatet e hulumtimit bazohen kryesisht në të dhënat që dalin nga përgjigjet që japin pjesëmarrësit në hulumtim e që janë kryesisht nxënësit e shkollave të mesme në regjionin e Gjilanit dhe më gjerë. Nga një studim i kryer nga një organizatë (STIKK)- Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK), një shoqatë e TIK-ut me seli në Prishtinë tregon se depërtimi i internetit në Kosovë është në një shkallë të kënaqshme dhe se mund të krahasohet me vendet e zhvilluara. Depërtimi i internetit në bazë të përdoruesve është 76.6%.⁹ Ekzistojnë arsye të ndryshme për këtë shkallë të lartë të depërtimit të internetit. Arsyeja kryesore është mosha mesatare shumë e re e popullsisë në Kosovë, e cila dëshiron t'i ndjek trendet globale. Sipas të gjeturave të këtij studimi shumica e shprehive të përdoruesve të internetit-adoleshentët, e që janë më të shumtë në numër, janë të krahasueshme me trendet globale.

Duke u nisur nga fakti se si mostër për hulumtim janë marrë adoleshentët gjegj. nxënësit e shkollave të mesme të regjionit të Gjilanit dhe Ferizajt, atëherë mund të pohojmë se kjo është caktuar duke pasur parasysh, se këta fëmijë janë një fakt i përgjithshëm që mund të jep rezultate, të cilat do të hedhin dritë mbi këtë problematikë dhe do të ndihmojnë në përcaktimin e avantazheve dhe disavantazheve që sjell përdorimi i internetit nga kjo pjesë e shoqërisë. Këtu janë përfshirë adoleshentët nga mosha të ndryshme në regjionin e Gjilanit duke filluar nga 14-të e deri në 18-të vjet. Mbledhja e informacioneve do të bëhet me anë të pyetësorëve me qëllim që informacionet të jenë sa më objektive, konfidenciale dhe të pandikuara.

Hulumtimi i kësaj teme është bërë mbi ato sfonde që sjellin sa më shumë të dhëna për informim sa më të thellë dhe kompleks, të zhvillimeve shoqërore të kohës me protagonist

⁹ Shoqata për teknologji të informacionit STIKK shih https://stikk.org/wp-content/uploads/2018/11/Publications_2013_-_Internet_Penetration_SO.pdf 2021/04

adoleshentët. Pra përgjithësisht është synuar hulumtimi i përfshirjes së adoleshentëve përdorues të internetit në Kosovë e në veçanti në regjionin e Gjilanit.

Punimi përbëhet nga kapituj e nënkapituj të cilët do të japin hollësitë dhe detajet e nevojshme për të arritur deri te rezultatet e pritura. Në secilin kapitull analizohen fakte të cilat do t'i nënshtrohen një arsytimi racional përmes analizës analitike në një marrëdhënie shpjeguese me nevojën për përdorimin e internetit, faktorët që ndikojnë në përdorimin në masë të madhe nga të rinjtë- adoleshentët, favoret që sjell ky përdorim dhe dëmet që mund të sjellë përdorimi në masë të tepruar. Për të qenë sa më objektiv kërkimi fokusohet te të rinjtë e regjionit të Gjilanit dhe Ferizajt duke përfshi shkollat e mesme. Përmes analizës së rezultateve, fokusi përqendrohet te relacioni në mes shkallës së përdorimit të internetit nga nxënësit nëpër shkolla dhe dobive e dëmeve që sjell përdorimi i internetit.

Objektivi i studimit

Objektivi kryesor i këtij studimi është ofrimi i një pasqyre të përdorimit të internetit nga adoleshentët, mbulimi i nevojave të ndryshme dhe të zbrazëtirës që ekziston në të dhëna sa i përket dobive dhe dëmeve që sjell përdorimi i internetit, pra relacionin në mes sasisë dhe cilësisë që sjell ky përdorim në masë të madhe, sidomos nga adoleshentët. Në bazë të të dhënave në dispozicion, duket e qartë se ekziston një nevojë e madhe për studime të detajuara dhe të herëpashershme, të cilat do të trajtonin probleme relevante, do të mbështesnin këta të rinj, si dhe do të krijoheshin mundësi dhe praktika që do të sjellin mundësi të reja për të rinjtë, kjo, duke u bazuar në informatat e ofruara. Ky studim po ashtu synon t'i kuptojë më mirë qëndrimin dhe shprehitë e përdoruesve ndaj internetit. Natyrisht, realizimi i temës i nënshtrohet kritereve të caktuara të hulumtimit, ku objektivat kryesore arrihen në analizën dhe përshkrimin e rezultateve që dalin përmes mjeteve që përdoren në hulumtim si p.sh. pyetësorët, meqë rast iu jepet përgjigje edhe pyetje kërkimore të cilat kërkojnë përgjigje.

Është me rëndësi tejet të madhe të kuptuarit se si e shfrytëzojnë të rinjtë internetin, e në veçanti adoleshentët. Kjo, me qëllim të fuqizimit të mëtejshëm të gjeneratave të reja të Kosovës në shfrytëzimin e TIK-ut si një instrument. Prandaj ky studim gjithashtu synon krijimin e një baze

studimore, e cila monitorohet dhe analizohet edhe më tej me fokus se si shkathtësitë për TIK të të rinjve kosovarë mund të kanalizohen në përdorimin e shëndoshë të faqeve të internetit në shërbim të dobisë që sjell përdorimi i internetit. Faza e hulumtimit, nxori në pah se nuk është e identifikuar sa duhet problematika e marrë për shqyrtim, sidomos në Kosovë.

Qëllimi i Studimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të bëhet një analizë studimore, të vlerësohet marrëdhënia ndërmjet nivelit të përfshirjes së të rinjve- adoleshentëve kryesisht mosha 14-18 vjeç në përdorimin ose jo të internetit, efektet që sjell përdorimi i internetit në zhvillimin psiko-social të kjo grup-moshë, ndikimi që ka në procesin edukativo arsimor si dhe rolin që luajnë prindërit në këtë proces. Një arsye shtesë për t'i hyrë kësaj teme është edhe fakti se ky hulumtim synon të sjellë risi në këtë fushë duke ndihmuar prindërit, shkollat, psikologët e shkollave, punonjësit social, politik bërësit, hartuesit e planeve dhe programeve shkollore, studiuesit. Pra hulumtimi synon të mbulojë shumë aspekte të përvojës së adoleshentëve si përdorues të internetit: rrjetet sociale dhe qëndrimi në internet; ndërtimin e identitetit dhe anëtarësimi në grup; efekti që mund të kenë lojërat që luajnë; zhvillimin e aftësive teknologjike; përdorimi i këtyre aftësive për mësim; përballimi i rreziqeve që shfaqen me përdorimin e internetit si dhe shfrytëzimi i burimeve të teknologjisë në rrugëtimin e tyre jetësor, pra dobisë dhe dëmet që sjell përdorimi i internetit nga kjo moshë; me specifika të veçanta e delikate.

Metoda e hulumtimit/ Hipotezat

Ky është një studim i cili, grumbullon të dhënat me anën e metodës cilësore dhe sasore, përshkruan dhe analizon njëkohësisht përdorimin e internetit nga adoleshentët e moshës 14-18 vjeç dhe ndikimin që kanë në zhvillim psiko-social dhe në procesin arsimor. Studime të mëparshme në këtë fushë kanë lënë hapësirë për një hulumtim tjetër nga i cili do të mund të përfitonin studiuesit

e ardhshëm duke aplikuar një metodologji përgjithësuese. Përdorimi i saj na ndihmon të kuptojmë dhe shpjegojmë ndikimin e internetit në zhvillimin psiko-social dhe në procesin arsimor duke marrë në konsideratë dhe karakteristikat që ka kjo grup-moshë. Mbledhja e të dhënave për këtë hulumtim ka filluar së pari me shqyrtimin e literaturës. Gjatë kësaj faze u morën parasysh burimet dytësore, duke e shfrytëzuar literaturën dhe njohuritë ekzistuese. Fushëveprimi i këtij studimi përfshinë sasinë dhe cilësinë e shfrytëzimit të internetit (shprehitë e përdoruesve) sidomos nga të rinjtë, posaçërisht nga adoleshentët që do të merren edhe si etalon për këtë hulumtim. Për të qenë sa më objektiv kërkimi është fokusuar te të rinjtë e regjionit të Gjilanit duke përfshi shkollat e mesme. Përmes analizës së rezultateve të nxjerra përmes pyetësorëve, fokusi përqendrohet te relacioni në mes performancës së shkollës dhe shkallës së përdorimit të internetit nga nxënësit nëpër shkolla. Për të grumbulluar informacionin sipas pyetjeve kërkimore në këtë studim u aplikuan instrumentet e kërkimit si më poshtë:

Pyetësi për nxënësit e shkollave të mesme i cili përbëhet nga 5 seksione të cilat matin, përshkruajnë dhe vlerësojnë përfshirjen e nxënësve në internet aktivitetet që ata bëjnë dhe motivet që i shtynjë drejt përdorimit të tyre. Në pjesën e parë grumbullohet informacion i përgjithshëm (si gjinia, mosha etj.) ndërsa në pjesën e dyte grumbullohet të dhëna për statusin social të të rinjve pjesëmarrës në hulumtim, në seksionin e tretë nxirret informacion dhe të dhëna për nxënësit, përdorues të internetit. Në seksionin e katërt nxirren rezultate për hipotezën kryesore. Në seksionin e pestë kërkohen rezultate për dobitë që mund të sjellë përdorimi i internetit dhe faktorë që ndikojnë në zhvillimin e kësaj dukurie.

Kërkimi primar është mbështetur në analizën e të dhënave të mbledhura nëpërmjet pyetësorëve të shpërndarë tek nxënësit e shkollave të mesme të regjionit të Gjilanit dhe është kryer përmes një qasje kuantitative; përmes pyetësorit elektronik. Pyetësorët janë shpërndarë përmes mesengjerit te grupet e caktuara të nxënësve nëpër shkolla të katër komunave, përfshi Gjilanin, Kamenicën, Vitinë dhe Ferizajn nga data 28 prill 2021 deri me 4 maj 2021, ndërkaq rezultatet janë grumbulluar nga data 29 prill 2021 deri më 15 maj 2021

Për këtë hulumtim janë shpërndarë 600 pyetësor ndërsa i janë përgjigjur 501 respondentë, që u përkasin shkollave të mesme të regjionit të Gjilanit dhe Ferizajt. Pra ky punim ka për qëllim të testojë lidhjet ndërmjet variablave të modelit analitik të marra në studim dhe, duke përshkruar

dhe analizuar njëkohësisht, t'i japë përgjigje pyetjeve kërkimore të mëposhtme si dhe të vërtetojë hipotezën kryesore dhe ato ndihmëse.

Pyetjet qe shtrohen/hipotezat

Fazat e mëtutjeshme të hulumtimit mbarështrohen përmes pyetjeve kërkimore: kur dhe si hulumtojmë procesin e realizimit të qëllimeve të parashkuara.

Hipotezat

Hipoteza kryesore: Përdorimi i internetit kërkesë imediate e kohës.

Hipoteza e parë ndihmëse: Ekziston një lidhshmëri ndërmjet përdorimit të internetit dhe cilësisë në arsim te adoleshentët

Hipoteza e dytë ndihmëse: Interneti ndihmon në socializim me komunitetin dhe në nxënien e njohurive prandaj internet shihet si nevojë

Hipoteza e tretë ndihmëse: Ekziston një lidhje ndërmjet përdorimit të tepruar të internetit dhe shfaqjes së fenomeneve negative te adoleshentët.

Pyetjet kërkimore

- 1. Cili është niveli i përfshirjes së nxënësve në internet?*
- 2. A janë prindërit faktor i rëndësishëm në zhvillimin e kësaj dukurie?*
- 3. Si ndikon përdorimi i internetit ose jo, në zhvillimin psiko-social te kjo moshë (adoleshentët)?*
- 4. Si ndihmon interneti në procesin edukativo arsimor në kushtet që jemi sot (në kushte pandemie)?*
- 5. Si ndikon përdorimi i internetit në stilin e dobët të jetesës së adoleshentëve dhe në mënyrën e shëndetshme të jetesës?*

Rëndësia e temës

Nisur nga kompleksiteti i fenomenit-përdorimi i internetit nga adoleshentët, ky studim rreket të hedhë dritë dhe të hulumtojë në detaje të gjitha qasjet e kësaj problematike dhe ndikimin e drejtpërdrejtë të saj në jetën e adoleshentëve. Punimi e trajton fenomenin që nga gjeneza deri tek shfaqjet që ka në personalitetin e adoleshentëve dhe kahen që i jep jetës së tyre kur ata fillojnë edhe të bëhen të varur për shkak të përdorimit të pakontrolluar. Duke analizuar të dhënat që rrjedhin nga pyetësorët dhe duke i interpretuar ato në mënyrë të detajuar, punimi synon të hapë edhe perspektiva të reja studimore, të cilat jo vetëm e evidentojnë dhe e përshkruajnë fenomenin, por synojnë të japin edhe zgjidhje, sugjerime apo rekomandime.

Pra ky punim mund të shërbejë për të detajuar jetën e të rinjve tanë në internet sepse është bërë pjesë e aktiviteteve të jetës së tyre të përditshme dhe shihen si e ardhmja e komunikimit global.

Ndër të tjera studimi është i rëndësishëm sepse ka për synim të paraqes një panoramë realiste të situatës aktuale për ndikimin e internetit te adoleshentët kryesisht në regjionin e Gjilanit dhe Ferizajt duke e marrë si rast të përgjithshëm.

Rëndësia e këtij hulumtimi, qëndron edhe në arritjen e rezultateve që do të ndihmojnë në caktimin e prioriteteve për institucionet të cilat merren me problemet që prekin këtë moshë duke filluar nga familja, arsimi; hartuesit e planeve e programeve shkollore dhe të psikologëve. Rezultatet e arritura do të hedhin dritë mbi këtë problematikë duke ndihmuar edhe hulumtuesit e ardhshëm të kësaj fushe, sidomos ata që përdorin metodën krahasimtare. Arsyeja shtesë që më ka nxitë për ta hulumtuar këtë problematikë është fakti se është pjesë e përditshmërisë sime dhe i detyrohem zgjidhjes së problemeve që dalin nga çështja që është marrë për hulumtim

Literatura

- AlAlwan, A., Rana, N. P., Dwivedi, Y. K., & Algharabat, R. (2017). Social Media in Marketing: A review and analysis of the existing literature. *Telematics and Informatics* Available at <http://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0736585317301077>
- Craparo, Messina, G., Severino, R., Fasciano, S., Cannella, S., Gori, V., Cacioppo, A., Baiocco, M., & Roberto. (2014) The relationship between self-efficacy, internet addiction and shame. *Indian Journal of Psychological Medicine*. 36(3).
<https://www.questia.com/searchglobal#!/?keywords=self%20esteem%20and%20internet%20addiction!%20All%20Words&pageNumber=1&mediaType=journals> gjetur ne mars 2021.
- Eric Zhi Feng Liu (2011). Avoiding internet addiction when integrating digital games into teaching. *Society for Personality Research*. 39(10). 1325-1336.
- Gencer, Koc, S. L. & Mustafa. (2012). Internet abuse among teenagers and its relations to internet usage patterns and demographics. *Educational Technology & Society*, 15 (2). 25-36.
- Isiklar, Sar, A., Durmuscelebi, A.H. & Mustafa (2013). An investigation of the relationship between high – school students’ problematic mobile phone use and their self-esteem levels. *Education*, 134(1).
<https://www.questia.com/searchglobal#!/?keywords=self%20esteem%20and%20internet%20addiction!%20All%20Words%20&pageNumber=1&mediaType=journals>, Gjetur ne mars 2021
- Kalmus, Realo, V., Siibak, A. & Andra (2011). Motives for Internet Use and their Relationship with Personality Traits and Socio-Demographic Factors. *TRAMES*, 15(4).
<https://www.questia.com/library/journal/1G1-275576223/motives-for-internet-use-andtheir-relationships-with>
- Kuss, D.J., Van Rooij, A.J., Shorter, G.W., Griffiths, M.D. & Van de Mheen, D. (2013). Internet Addiction in adolescents: Prevalence and risk factors. *Computers in Human Behavior*. 29, 1987-1996. <http://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0747563213001052>
- Laconi, S., Tricard, N. & Chabrol, H. (2015). Differences between specific and generalized problematic internet uses according to gender, age, time spent online and psychopathological symptoms. *Computers in Human Behavior*. (48). 236-244.
- Lee, Wai-Yu, Z., & Mei-Kwan, Christy (2014) Problematic Use of Social Networking Sites: The role of Self-Esteem. *Interneational Journal of Business and Information*. 9(2).
<https://www.questia.com/searchglobal#!/?keywords=self%20esteem%20and%20internet%20addiction!%20All%20Words&pageNumber=1&mediaType=journals>, Gjetur ne maj 2021.
- Lehman, Konstam, I.S., & Varda (2011). Growing up perfect: perfectionism, problematic internet use, and career indecision in emerging adults. *Journal of Counseling and Development*. 89(2).
<https://www.questia.com/library/journal/1G1-252289120/growingup-perfect-perfectionism-problematic-internet>, Gjetur ne maj 2021.

- Ostovar, Sh., Allahyar, N., Aminpoor, H., Moafian, F., Md Nor, M.B., & Griffiths, M.D. (2016). Internet Addiction and its Psychosocial Risks (Depression, Anxiety, Stress and Loneliness) among Iranian Adolescents and Young Adults: A structural Equation Model in a Cross – Sectional Study. *International Journal of Mental Health and Addiction*. https://www.academia.edu/23697208/Ostovar_S._Allahyar_..._and_Griffiths_M.D._2016_
- Quinones, C., Griffiths, M.D., & Kakabadse N.K. (2016). Compulsive Internet use and workaholism: An exploratory two-wave longitudinal study. *Computers in Human Behavior*. (60). 492-499. https://www.academia.edu/23202544/Quinones_C._Griffiths_M.D._and_Kakabadse_N._2016_ *Compulsive Internet use and workaholism An exploratory twowave longitudinal study Computers in Human Behavior_60_492-499*. Gjetur në mars 2021.
- Saliu, H. (2021). The specifics and complexity of EU public diplomacy. *Druzboslovne Razprave, XXXVII*(96–97), 189–207. <https://www.sociolosko-drustvo.si/wp-content/uploads/2021/09/DR96-97-Saliu-WEB.pdf>
- Schimmenti, A., Guglielmucci, F., Barbasio, Ch., & Granieri, A. (2012). Attachment disorganization and dissociation in virtual worlds: A study on problematic internet use among players of online roleplaying games. *Clinical Neuropsychiatry*. 9(5).
- Shehu, A. (2012). Komunikimi, interneti dhe të rinjtë. Buletini Shkencor, Universiteti Fan Noli, Korçë.
- Udris, Reinis (2015). Cyberbylling in Japan: An exploratory Study. *International Journal of Cyber Society and Education*. 8(2). <https://www.questia.com/read/1P3-3912419481/cyberbullying-in-japan-an-exploratory-study>
- UNICEF (2011) “Fëmijët dhe Media. Një sondazh i opinionit të fëmijëve dhe të rinjve për përdorimin dhe besueshmërinë e medias” <http://www.institutemedia.org/Documents/PDF/femijet%20dhe%20media%20shqip%20per%20shtyp.pdf> Gjetur në prill 2021
- Zhapaj, E. (2014). Varësia nga interneti dhe impakti i saj në performancës shkollore të nxënësve.
- Zhong, X., Zu, S., Sha, S., Tao, R., Zhao, C., Yang, F., Li, M. & Sha, P. (2011). The effect of a family – based intervention model of internet – addicted Chinese adolescents. *Social behavior and personality*, 39(8), 1021-1034. <https://www.sbpjournal.com/index.php/sbp/article/view/2189>, gjetur në qershor 2021.
- <http://www.ata.gov.al/vezhgim-te-rinjte-mes-rrjeteve-sociale-dhe-librave-195075.html> Gjetur në qershor 2021
- https://www.academia.edu/3477361/Internet_addiction_individual_differences_and_wellbeing_among_Thai_students_in_a_private_university, Gjetur në qershor 2021.
- (Amichai-Hamburger & Ben-Artzi, 2003; Chou & Hsiao, 2000; Morahan-Martin & Schumacher, 2003; Oldfield & Howitt, 2004; Shaw & Gant, 2002a

- Amichai-Hamburger, Y., & Ben-Artzi, E. (2003). Loneliness and Internet use. *Computers in Human Behavior*, 19(1), 71–80. [https://doi.org/10.1016/S0747-5632\(02\)00014-6](https://doi.org/10.1016/S0747-5632(02)00014-6),
- Leonard, L. B. (1998). *Children with specific language impairment*. Cambridge, MA: Washington, DC: Pew Internet and American Life Project
- American Academy of Pediatrics Council on Communications and Media. (2009). *Policy Statement-Media Violence*. *Pediatrics*, 124(5), 1495-1503. <http://pediatrics.aappublications.org/content/124/5/1495.full.pdf>
- Gentile, D. (2009). *Pathological video-game use among youth ages 8-18*. *Physiological Science*, 20(5), 594-603. http://www.drdouglas.org/drddpdfs/Gentile_Pathological_VG_Use_2021e.pdf
- Lenhart, A. (2012). *Teens, smartphones & texting*. Washington, D.C.: Pew Research Center's Internet & American Life Project. [http://www.pewinternet.org/~media/Files/Reports/2012/PIP_Teens_Smartphones_and_Texting.pdf](http://www.pewinternet.org/~/media/Files/Reports/2012/PIP_Teens_Smartphones_and_Texting.pdf)
- McQuade, S., & Sampat, N. (2008). *Survey of Internet and At-Risk Behaviors, Rochester Institute of Technology. Monroe County, NY: Report of the Rochester Institute of Technology*, 7. [http://csla2008.pbworks.com/f/RIT%20Cyber Survey Final Report \[2\].pdf](http://csla2008.pbworks.com/f/RIT%20Cyber%20Survey%20Final%20Report%20[2].pdf)
- Rideout, V. (2012). Social media, social life: How teens view their digital lives: A CommonSense Media Research Study. <http://www.commonsensemedia.org/sites/default/files/research/socialmediasociallife-final-061812.pdf>

REFERENCAT

1. Lenhart, A., Madden, M., & Hitlin, P. (2005). *Teens and technology*, Washington, DC: Pew Internet and American Life Project
2. TheWorld Bank (2020). *Annual Report 2019 Organizational Information*. Marrë nga webfaqja. <http://pubdocs.worldbank.org> › worldbankannual...
3. Kasapolli, A.S. (2016). *Të rinjtë, aktivë në mediet sociale*. Evropa e Lire. Marrë nga webfaqja <https://www.evropaelire.org/a/28011457.html>
4. Eldeleklioglu, J. & Vural-Batik, M. (2013). *Predictive effects of academic achievement, internet use duration, loneliness and shyness on internet addiction*. *Journal of Education*, 28 (1), 141-152

5. Vicky Rideout, M.A., VJR Consulting Inc. (2015). *THE COMMONSENSE CENSUS: MEDIA USE BY TWEENS AND TEENS 39*, Delaney Family Fund. Marrë nga webfaqja. https://www.common sense media.org/sites/default/files/uploads/research/census_researchreport.pdf
6. Fazliu. A. (2013). *Depërtimi dhe përdorimi i internetit ne Kosovë*. Kolegji Universitar Universum marrë nga webfaqja https://stikk.org/wcontent/uploads/2018/11/Publications_2013_-_Internet_Penetration_SQ.pdf
7. [A. Desara, \(2016\). *Varësia nga Interneti tek Adoloshentët në Shqipëri*. UNIVERSITETI I TIRANËS. Për më shumë shih <http://www.doktoratura.unitir.edu.al> › 2021/05](http://www.doktoratura.unitir.edu.al)
8. Hendrick. B. (2010). *Internet Addiction Spins Web of Depression*. Webside <https://www.webmd.com/depression/news/20100204/internet-addiction-linked-to-depression>
9. Shoqata për teknologji të informacionit STIKK shih https://stikk.org/wcontent/uploads/2018/11/Publications_2013_-_Internet_Penetration_SQ.pdf
10. American Academy of Pediatrics Council on Communications and Media. (2013). *Impact of Media and Technology on Youth*. Webside https://www.nsvrc.org/sites/default/files/2013-12/publications_nsvrc_factsheet_impact-of-media-and-technology-on-youth.pdf
11. Crosnoe R. Johnson N. (2011). *Research on Adolescence in the Twenty-First Century*. Marrë nga https://www.researchgate.net/publication/228173881_Research_on_Adolescence_in_the_Twenty-First_Century
- 11.1 Chak, K., & Leung, L. (2004). *Shyness and locus of control as predictors of Internet addiction and Internet use*. *CyberPsychology and Behavior*, 7, 559–570.
12. ReachOut.com.(2021). *Technology and teenagers*. Marrë nga webfaqja <https://parents.au.reachout.com/skills-to-build/wellbeing/technology-and-teenagers>
13. [Po aty](#)
14. Wiley Online Library. (2011). The effect of social network sites on adolescents' social and academic development: Current theories and controversies. Marrë nga webfaqja <https://onlinelibrary.wiley.com/doi/abs/10.1002/asi.21540> marrë më 01.06.2021

15. Cherry. K. *Identiteti kundrejt konfuzionit te rolit*. Marrë nga <https://sq.reoveme.com/identiteti-kundrejt-konfuzionit-te-rolit/>,2021/06
16. <https://sq.nsp-ie.org/teorias-de-personalidad-en-psicologia-erik-erikson-684b-4b80>
17. Cherry. K. *Identiteti kundrejt konfuzionit te rolit*. Marrë nga <https://sq.reoveme.com/identiteti-kundrejt-konfuzionit-te-rolit/> më 16.06. 2021
18. Po aty
19. Dunja A, Gjergji O, Gvineria D, Hallkaj E, dhe Verzivolli I. (2019) *Një Klikim Larg: Përvoja e përdorimit të internetit nga fëmijët në Shqipëri*. UNICEF në Shqipëri & IPSOS Strategic Marketing, Tiranë. (F.11), marre nga webfaqja: https://www.unicef.org/albania/media/2581/file/NJe_klikim_larg_2020.pdf marrë më 26.06.2021
20. Peza.A.(2019). *Cilësia e jetës dëmtohet kur adoleshenti kalon shumë kohë në rrjete sociale*. Marre nga <https://www.portalishkollor.al/kuriozitet/anhela-peza-cilesia-e-jetes-demtohet-kur-adoleshenti-kalon-shume-kohe-ne-rrjete-sociale>
21. po aty
22. Masih.J. & Rajkumar.R. (2019). *Internet Addiction Disorder and Mental Health in Adolescents*. J Depress Anxiety S13: 002. Për më shumë shih <https://www.longdom.org/open-access/internet-addiction-disorder-and-mental-health-in-adolescents.pdf>
23. <https://sq.nsp-ie.org/la-adiccion-a-internet-824-2004> marrë më 02.05.2021
- 24 A. Desara, (2016). *Varësia nga Interneti tek Adoloshentët në Shqipëri*. UNIVERSITETI I TIRANËS. marre nga webfaqja <http://www.doktoratura.unitir.edu.al> › 2021/05-
25. Ferrara, E., Yang, Z. (2015) *Matja e ngjitjes emocionale në mediat sociale*. PLOS NJE, 10, 1-Marrë nga <https://tiranapost.al/inteligenca-emocionale-cfare-eshte-dhe-perse-na-sherben/>
26. Saliu, H. (2021). The specifics and complexity of EU public diplomacy. *Druzboslovne Razprave*, XXXVII(96–97), 189–207. <https://www.sociolosko-drustvo.si/wp-content/uploads/2021/09/DR96-97-Saliu-WEB.pdf>
27. Dunja A, Gjergji O, Gvineria D, Hallkaj E, dhe Verzivolli I. (2019) “NJË KLIKIM LARG, Përvoja e përdorimit të internetit nga fëmijët në Shqipëri “ (f.63) Shih linkun: https://www.unicef.org/albania/media/2581/file/NJe_klikim_larg_2020.pdf, Marrë më 12.06.2021

28. Desara. A., (2016). *Varësia nga Interneti tek Adoleshentët në Shqipëri*. UNIVERSITETI I TIRANËS. marre nga webfaqja <http://www.doktoratura.unitir.edu.al> › 2021/06,(fq. 1)
29. Desara. A., (2016). *Varësia nga Interneti tek Adoleshentët në Shqipëri*. UNIVERSITETI I TIRANËS. marre nga webfaqja <http://www.doktoratura.unitir.edu.al> › 2021/04(fq. 41)
- 30.. Desara.A., (2016). *Varësia nga Interneti tek Adoleshentët në Shqipëri*. UNIVERSITETI I TIRANËS. marre nga webfaqja <http://www.doktoratura.unitir.edu.al> › 2021/04(f,23)
31. Griffiths, M.D. (1998). *Varësia nga interneti: A ekziston vërtet?* Tek J. Gackenbach (Ed.), *Psikologjia dhe Interneti: Ndërlikimet nder personale, dhe trans personale* (f. 61-75). NewYork: Shtypi Akademik.
32. Desara.A, (2016). *Varësia nga Interneti tek Adoleshentët në Shqipëri*. UNIVERSITETI I TIRANËS. marre nga webfaqja <http://www.doktoratura.unitir.edu.al> › 2021/05 (f. 12)
33. Hendrick. B. (2010). *Internet Addiction Spins Web of Depression*. Webside <https://www.webmd.com/depression/news/20100204/internet-addiction-linked-to-depression>
34. po aty
35. Newman S. (2016). *Teens and the Internet: How Much Is Too Much?* Marre nga <https://www.psychologytoday.com/us/blog/stepmonster/201004/teens-and-the-internet-how-much-is-too-much>
36. Kasapolli. A.S. (2016). *Mbi 70 mijë fëmijë përdorues të internetit në Kosovë..* Evropa e Lire. Marrë nga webfaqja <https://www.evropaelire.org/a/perdorimi-i-internetit-femijet/29933806.html>
37. Becker MW, Alzahabi R, Hopwood CJ (2013) *Media multitasking is associated with symptoms of depression and social anxiety*. *Cyberpsychology, Behavior, and Social Networking* 16: 132-135.
38. Kraut, R., Patterson, M., Lundmark, V., Kiesler, S., Mukopahyay, T. & Scherlis, W. (1998). *Paradoksi në internet: Një teknologji sociale që zvogëlon përfshirjen sociale dhe mirëqenien psikologjike?* *Psikolog Amerikan*, (f.1017-1031).

39. Desara.A, (2016). *Varësia nga Interneti tek Adoleshentët në Shqipëri*. UNIVERSITETI I TIRANËS. marrë nga webfaqja <http://www.doktoratura.unitir.edu.al> › 2021/05(fq. 39)
40. Echeburúa, E. dhe Corral, P. (1994). *Varësitë psikologjike: përtej metaforës. Klinika dhe Shëndetësia*, 5, 251-258.
- 41.” Eldeleklioglu, J. & Vural-Batik, M. (2013). *Predictive effects of academic achievement, internet use duration, loneliness and shyness on internet addiction. Journal of Education*, 28 (1), 141-152
- 41 Desara.A, (2016). *Varësia nga Interneti tek Adoleshentët në Shqipëri*. UNIVERSITETI I TIRANËS. marre nga webfaqja <http://www.doktoratura.unitir.edu.al> › 2021/06 (fq. 27)
42. Po aty (fq. 27)
43. Fatmir. F& Gëzim. S. *Teknologjisë informative te të rinjtë e Prishtinës*, Gnosis, (Institute Kosovar për studime sociale), (f.26)
44. Weinfeld, Sroufe, Egeland,&Carlson.(2017). *Student-teacher relationships and ethnic outgroup attitudes among majority students*Article in *Journal of Applied Developmental Psychology* · Prill 2021 (f.56,57)
45. Kasapolli. A.S. (2016). Të rinjtë, aktivë në mediat sociale. Evropa e lire. Për më shumë shih <https://www.evropaelire.org/a/28011457.html>.
46. Kosof. M. (2014). *420 Million people are addicted to the internet*. Marrë nga <http://www.businessinsider.com/420-million-people-are-addicted-to-the-internet-study-2021-6>).
47. Doa.A& Strickland.B.(2015). *Teens spend up to 88 hours a week gaming in Korea*. Marrë nga <http://www.hooked-on-games.com/blog/view-articles-in-a-list/129-teens-spend-up-to-88-hours-a-week-gaming-in-korea.html>
- 48 <https://www.coursehero.com/file/p25ts6r/orld-Vision-Albania-and-Kosovo-ka-kryer-nj%C3%AB-studim-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri-n%C3%AB-periodh%C3%ABn/>
- Fig.1. <https://www.infocentarjug.rs/prinderit-digjital-mbrojtja-e-femijeve-ne-kohen-e-ndarjes/> gjetur më 18 qershor 2021
- Fig. 2. figurë e marrë nga <http://www.scan-tv.com/efektet-negative-te-varesise-nga-interneti-ne-adoleshence/më-20-qershor-2021>

Fig.3. <https://www.isigurt.al/2021/06>